



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga dëgjimi publik për planifikimin e buxhetit të vitit 2023, mbajtur më 09.08.2022, i cili filloi në orën 14:00.

Në mbledhje morën pjesë: **Lumturije Gashi, Albanë Rexha, Lumnije Çitaku, Indire Zenelaj, Rifadije Sopi, Milazim Vitija, Shpresa Shala, Betim Sylejmani, Fatmir Zhdrella, Besart Ismajli, Islam Nitaj, Nazif Jashari, Besim Korça, Xhevat Rafuna, Naim Bytyqi, Mimoza Krasniqi, Fatmir Dervishi, Shqipe Kqiku, Ermal Osmani, Rashit Gashi, Gëzim Sveçla, Arben Kelmendi, Besart Krasniqi, Gëzim Mehmeti, Violeta Salihu, Lorentë Alija, Tria KasumiBerisha, Fatmire Rizani-Krasniqi, Supije Zhitija, Shemsedin Beqiri, Daut Selimi, Musli Dulahi, Haki Dili, Bekë Mulaj, Arsim Gashi, Skënder Halimi, Milaim Islami, Isak Xhemajli, Xhevrije Osmani, Bedrije Pireva, Jeta Diola-Bujani.**

Të pranishëm ishin edhe :**Donjeta Sahatçiu**, nënkryetare, **Valbona Makolli**, drejtore e Drejtorisë së Financave, **Besianë Musmurati**, drejtore e Drejtorisë së Arsimit, **Ilirik Musliu**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Osman Bllaca**.

Osman Bllaca i përshëndeti të pranishmit dhe i njoftoi se në këtë takim do të diskutojnë për të gjitha nevojat dhe kërkesat të cilat rrjedhin nga të gjitha nivelet e arsimit, që janë në kuadër të Komunës së Prishtinës, respektivisht të Drejtorisë së Arsimit.

Valbona Makolli, drejtore, përshëndeti dhe falënderoi të pranishmit për kohën që ndanë për pjesëmarrje në këtë diskutim për propozimbuxhet.

Faqe 1 nga 6

Ajo i njoftoi të pranishmit se materialin të cilin e kemi përgatitur është propozimbuxhet vetëm për investime kapitale, mirëpo ky është vetëm projekt, nuk është përfundimtar, andaj kërkesat tuaja në këtë takim janë të mirsardhura.

Kryeqyteti sipas Qarkores së parë për vitin 2023, do ta ketë një buxhet përafërsisht 105.495.891 Euro, të ndara në pesë kategori: "Paga dhe mëditje", diku 33 milionë, "Mallra dhe shërbime", 27 milionë e 500 mijë, "Komunale" 2 milionë e 700 mijë, "Subvencione" 4 milionë e 650, dhe "Investime kapitale" 40.156.981.

Para se të dorëzohet në Kuvend buxheti, do t'i shqyrtojmë të gjitha kërkesat tuaja, të cilat ne sot do t'i pranojmë dhe do t'i shohim mundësitë e realizimit të tyre.

Osman Bllaca i sugjeroi të pranishmi që fillimisht ta bëjnë prezentimin, pastaj të diskutojnë.

Fatmir Zhdrella, drejtor i shkollës " Dëshmorët 1921", Prapashticë, komuna e Prishtinës, tha se në bazë të numrit të nxënësve në shkolla dhe në krahasim me shkollat e komunave të tjera, ne si kryeqytet kemi një ndarje shumë të vogël të buxhetit për furnizime me rekuizita sportive.

Shemsedin Beqiri, drejtor i gjimnazit "Eqrem Çabej" në Prishtinë, tha se në gjimnazin tonë duhet të bëjmë disa ndryshime, duke filluar nga sistemi i ngrohjes, që ne vazhdimisht kemi probleme pasi që është i pamjaftueshëm, ndërrimin e disa dyerve të klasave, pastaj çështja e gëlqerosjes së shkollës, ndërrimin e një pjese të dritareve të dëmtuara, rregullimin dhe sanimin e nyjave sanitare në banjot e nxënësve. Ndriçimi tek ne është filluar, por është ndërprerë në gjysmë dhe kështu kemi një disbalancë nëpër klasa, ndërsa në oborrin e shkollës nuk funksionon fare ndriçimi, pos në pjesën e brendshme, që kemi një reflektor dhe fare lehtë mund të ofrohet dikush dhe të mos shihet se është duke frekuentuar pranë shkollës.

Shpresa Shala tha se shkolla "Xhemajl Mustafa" është shkollë e cila është në rrugë, në fakt nuk ka oborr të shkollës fare dhe na duhet një pjesë e cila është me shtylla antiparking, të vendosim një pengës që veturat nga jashtë të mos hyjnë, sepse kemi pasur raste kur kemi pasur fëmijë me nevojë për ndihmë, për emergjencën, por nuk ka pasur mundësi emergjenca të hyjë brenda për të ofruar ndihmë. Po ashtu, në shkollën tonë duhet ta bëjmë ndërrimin e dritareve, pasi që verës është shumë nxehtë dhe dimrit edhe pse kemi ngrohje nga "Termokosi", shkolla nuk ofron ngrohje të mjaftueshme për shkak të izolimit të dobët.

Besianë Musmurati, drejtore e Drejtorisë së Arsimit, i njoftoi të pranishmit me disa nga problemet që kanë të bëjnë me kontratat e përgjithshme, të cilat kanë qenë të bllokuara nga OSHP, dhe tani veç se ka filluar zhbllokimi i këtyre kontratave. Në momentin e parë që ato nënshkruhen, atëherë do të fillojnë investimet, gëlqerosja veçse ka filluar me çerdhet, për shkak që fëmijët do të kthehen nëpër çerdhe këtë javë dhe do vazhdojmë me shkolla ashtu

siç e kemi në plan, varësisht prej gjendjes, me shkollën "Sami Frashëri", "Hasan Prishtina", "Pjetër Bogdani".

Ne përpos kontratave kornizë që i kemi, p.sh. për nyja sanitare, kemi disa shkolla, si "Elena Gjika", "Dardania" e kështu me radhë, që kanë kërkesa specifike dhe nuk mund t'i mbulosh me një kontratë të përgjithshme. Kështu që këtë buxhet do ta shfrytëzojmë që të planifikojmë buxhet dhe të planifikojmë zhvillim individual për shkolla. Kemi filluar me shkollën "Iliria", që në shtator po besojë se do të jetë një shkollë komplet e rinovuar, në bashkëpunim me NPB-në, e cila na ka ndihmuar, dhe kështu do të vazhdojmë edhe me shkollat e tjera.

Rifadije Sopi, drejtore e çerdhes "Yllkat", i parashtroi dy kërkesa, njëra ka të bëjë me ndërrimin e sistemit të nxemjeve qendrore me lëndë djegëse në sistemin me pompë termike dhe kërkesa tjetër është për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, për zhvendosjen e një shenje, e cila e specifikon një pjesë ku e ndanë rrugën njëkahore, sepse aty po cenohet siguria e fëmijëve, pasi që ka lëvizje të pakontrolluara të veturave.

Supie Zhitia, drejtore e shkollës "Gjergj Fishta", tha se nevojat e shkollës sonë janë të shumta, mirëpo do t'i ceku vetëm disa që janë me shumë prioritet. Shkolla ka vjetërsi të theksuar dhe fasadimi i shkollës është më se i domesdoshëm. Shkolla jonë ka nevojë për një sallë të re të edukatës fizike, e cila është veç e aprovuar, por ka ngecje në këtë drejtim. Pastaj kemi nevojë për ndërrimin e inventarit, në veçanti të bankave të cilat janë të vjetëra, dhe furnizimin me pajisje teknologjike.

Bedrie Pireva, drejtore e shkollës "Ali Kelmendi", Barilevë, tha se shkolla në fshatin Barilevë ka nevojë të domesdoshme për rrethojë, për shkak të sigurisë së nxënësve, sidomos nga qentë endacakë. Po ashtu, kemi nevojë edhe për lyerjen e shkollës, ndërrimin e inventarëve dhe ndërrimin e dritarëve.

Indire Zenelaj, drejtore e institucionit parashkollorë "Gëzimi Ynë", tha se objekti ynë është në gjendje jo të mirë, jo të përshtatshme për pranimin e fëmijëve që i kemi aty, prandaj ne kemi nevojë që të bëhet renovim në tërësi. Ajo tha se kemi bërë kërkesë në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, për eliminimin e rrezikut nga drurët, por për shkak se terreni është i vështirë dhe nuk mund të hyhet me pajisje të mëdha, nuk ka përfunduar në tërësi eliminimi i tyre. Pastaj është largimi i një kontejneri, apo garazhi, i cila qëndron në afërsi të kopshtit të objekti numër 3.

Jeta Dida - Bujani, drejtore e shkollës së muzikës "Prenk Jakova", tha se desha ta përgëzoj Komunën e Prishtinës, bashkërisht me Drejtorinë e Arsimit, për iniciativën e ndërtimit të liceut artistik, pra ndërtimi i shkollës së muzikës "Prenk Jakova" këtu në Prishtinë dhe marrjen seriozisht të kërkesave të këtij komuniteti, i cili tash e 75 vjet pret ta ketë një objekt dinjitoz siç e meriton.

Lumturije Gashi, drejtore e institucionit parashkollor "Dielli", tha ne si institucion kemi nevojë për rregullimin e oborreve dhe terreneve sportive, për shkak të sigurisë dhe nevojës së fëmijëve për kryerjen e aktiviteteve sportive. Kemi probleme të vazhdueshme me ujin, i cili futet në bodrume, rregullimin dhe sanimin e banjave, shtretër dhe karrige të vjetëruara dhe të dëmtuara. Por kemi nevojë edhe për një shtëpiak, i cili kujdeset për mirëmbajtjen e vazhdueshme të institucionit.

Besianë Musmurati, drejtore, tha se kemi folur me drejtoreshën e shkollës "Gjergj Fishta", për sallën e sportit, sot e kemi pranuar prej NPB-së projektin e shkollës dhe do e vazhdojmë menjëherë me shpallje të tenderit dhe njëjtë shkon edhe me renovimin e fushës së jashtme sportive, pasi që e kemi parë bashkë që ka shumë nevojë për investim.

Sa i përket shkollës "Ali Kelmendi", gjithashtu jemi në proces të tenderimit për rrethoja dhe në momentin e nënshkrimit, menjëherë do të bëjmë furnizimin, pasi që ka qenë i bllokuar nga OSHP. Pra shkollën tuaj e kemi prioritet, bashkë me 2-3 shkolla të tjera, që kanë probleme të mëdha me qentë endacakë. Aty ku janë të prishura do të rregullohen dhe aty ku nuk ka fare, të vendosen që nga fillimi. Ndërsa "Gëzimi Ynë", objekti i parë, ka nevojë për renovim. Ne e kemi menduar që me këtë planifikimin e ri për renovim të tërësishëm dhe jo njëherë me gëlqerosje pastaj me kulme, sepse kështu nuk po është shumë e qëndrueshme. Për shkollën "Prenk Jakova", jemi shumë të lumtur që liceun artistik kemi arritur ta buxhetojmë në KAB, shpresojmë që së shpejti me ndihmën e kryetarit, të fillojmë procesin e planifikimit. Menjëherë pas vizitës në çerdhen "Dielli", kemi filluar bashkë me drejtoreshën Valbona, kemi shikuar se çka mundemi të bëjmë diçka më shpejt, për shkak se edhe ju, edhe "Lule Vera" janë prej oborreve që kanë nevojë më së shumti për rinovim, për këtë arsye me bartje ne e kemi bërë një bartje të buxhetit prej këtij viti. Sa i përket shtëpiakut, kemi probleme të vazhdueshme me Ministrinë e Financave, për shkak të stafit dhe të numrave me puntorët e arsimit, por në momentin e parë që do të krijohet ndonjë mundësi e re për marrjen e punëtorëve shtesë, me kënaqësi do ta bëjmë këtë.

Lumnije Çitaku, drejtore e çerdhes "Ardhmëria", tha se nuk është i planifikuar aneksi për çerdhen "Ardhmëria", e që do të ishte shumë i mirëseardhur një aneks me tri klasë, donacion, për të cilin kam kërkuar, por ende nuk kam marrë përgjigje dhe shpresoj që duhet të planifikohet në vitet e ardhshme 2023, 2024 apo 2025.

Milajim Islami, drejtor i shkollës "Nëna Terezë" në Vranidoll, tha se është shpallur tenderi, kanë filluar punimet dhe tashmë janë ndërprerë. Zyrtarisht nuk kam ndonjë informatë, përkundër kërkesave në email që i kam dërguar tek menaxheria e kontratës që ka qenë, me arsyetimin se Komuna tashmë është investitori dhe ajo jep llogari për gjithëçka. Por të paktën ta kemi një informatë se çka t'i informojë prindërit që vazhdimisht janë në presion, se a pritët ndonjë tenderim i ri apo do të vazhdojë ajo kontratë.

Besianë Musmurati, drejtore, tha se punët janë ndalur për shkak se operatori ekonomik është deklaruar që nuk mund të vazhdojë me çmimet aktuale të kontratës, për shkak se çmimet janë dy-trefishuar. Tash menaxheria e kontratës është duke e përfunduar prerjen e kontratës, pastaj do të vazhdojmë me rishpallje, dhe në momentin e realizimit të saj do të vazhdojmë me punët.

Milajim Islami, drejtor i shkollës “Nëna Terezë” në Vranidoll, pyeti se a do të caktohen edhe afate kohore për pjesën e mbetur të punëve?

Besianë Musmurati, drejtore, tha se çdo kontratë e ka afatin kohor, por ne do të mundohemi ta përsheptomë, për shkak se pastaj fillon edhe dimri dhe njëjtë do të vazhdojmë edhe me aneksin e shkollës “Pavarësia”, sepse gjendemi në një situatë të njëjtë ku duhet t’i përsheptomë punët, por normal duke mos e kompromentuar cilësinë.

Islam Nitaj, drejtor i shkollës teknike “28 Nëntori”, tha se kam bërë një kërkesë për mbindërtim në punëtorinë ekzistuese, që nuk është e planifikuar këtu, sepse kemi nevojë për ushtrimin e punës praktike. Po ashtu, të mundësohet qoftë për vitin e ardhshëm apo vitin 2024, edhe ridizajnimi i fasadës, që të jetë në harmoni me objektin ekzistues të shkollës. Kërkesa tjetër ka të bëjë me mundësinë e kyçjes së nxjemjeve në sistemin e ngrohjes së qytetit. Pika e tretë që dua ta diskutoj rreth kategorive buxhetore, a ka mundësi të kemi një buxhet deri në 100 euro për intervenim emergjent, dhe jo të pritët me muaj për shkak të procedurave burokratike. Kërkesa tjetër ka të bëjë me furnizimin me repromaterial në shkollat profesionale për punë praktike. Dhe e fundit që dua ta diskutoj është, a është planifikuar apo menduar ndërtimi i shkollës në lagjen “Mati 1”, sepse aty vazhdon të mos ketë asnjë shkollë fillore.

Besianë Musmurati, drejtore, tha se lidhur me kyçjen në sistemin e ngrohjes së qytetit “Termokos”, tashmë kemi diskutuar bashkë dhe e kam angazhuar një drejtor, që në emër të shtatë shkollave të bëjë një kërkesë drejtuar ndërmarrjes “Termokos”, pastaj të ulemi të diskutojmë për mundësitë e kyçjes në sistemin e ngrohjes. Sa i përket buxhetit për intervenime emergjente, unë sa e di ju keni të drejtën e shfrytëzimit të 100 eurove përmes faturave, vetëm nëse është paraqitur ndonjë problem për të cilin nuk kam dëgjuar. Materialin për punë praktike e kemi edhe në kuadër të furnizimit për kabinete. Ndërsa për shkollën në “Mati 1”, e kemi edhe me projektin e PPP-së, i cili fatmirësisht po vazhdon, sepse OSHP-ja më në fund ka kthyer përgjigje, ndërsa për projektin tjetër i cili është nga viti 2013, ka pasur probleme pronësore dhe tash së bashku me kryetarin, jemi duke shikuar ta gjejmë një zgjidhje.

Valbona Makolli, drejtore, dha një njoftim të shkurtër lidhur me “Petty cash”, është shumë e vërtetë se viteve të mëhershme çdo shkollë e ka pasur të drejtën e shfrytëzimit, por ka qenë një gjetje shumë më herët e auditorëve dhe e kanë larguar. Kemi biseduar edhe me

Ministrinë e Financave për mundësinë, që secila shkollë të mund të intervenojë në mënyrë emergjente deri në vlerë 500 euro, por ende nuk kemi marrë ndonjë përgjigje nga ta.

Betim Sylejmani, drejtor i shkollës "Elena Gjika", tha se si kërkesë specifike nga shkolla jonë, nëse është e mundur, të përfshihet ndërtimi i aneksit të shkollës tek ish-shkolla e muzikës, atëherë ne mund të dalim me ciklin 6-9 në atë objekt dhe është mundësia e vetme për të kaluar me një ndërresë.

Nazif Jashari, drejtor i shkollës fillore "Asim Vokshi", tha se oborri i shkollës sonë ose hyrja e oborrit të shkollës është shumë e papërshtatshme. Në pjesën veriore shkolla ka nevojë për renovim dhe izolim dhe, po ashtu një pjesë e rrethojës së shkollës nuk është e mirë. Salla e edukatës fizike ka nevojë për një renovim, duke filluar nga parketi. Ai tha se problem i shkollës "Asim Vokshi" vazhdon të mbetet ndriçimi jo i mirë dhe rreziku nga hyrja e shkollës, pasi që rruga është shumë e ngushtë, sidomos nga ora 13:00 deri në 14:00 ta shiqojmë nëse ka mundësi ta mbyllim ose ta bëjmë vetëm në një drejtim.

Xhevat Rafuna, drejtor i shkollës "Asim Vokshi" në Hajvali, tha se në shkollën tonë kemi probleme me nyjat sanitare, dyertë e hyrjes kanë filluar të çrregullohen dhe platforma para hyrjes së shkollës nuk ka strehë. Probleme tjetër është një pjesë e oborrit të shkollës, ku hedhen mbeturina të ndryshme dhe mund të shfaqen probleme të ndryshme.

Osman Bllaca, kryesues i mbledhjes, tha se nëse më lejohet, kisha sygjëruar që pjesa e terreneve sportive nëpër oborre të shkollave të mos shtrohen me taftanë, për shkak të cilësisë së dobët, por të shtrohet me bari sintetik apo artificial, pasi që është shumë më i mirë, më i butë për fëmijët dhe duket shumë më bukur.

Besianë Musmurati, drejtore, tha se kanë qenë disa arsyje që inxhinierët e NPB-së dhe inxhinierët brenda Komunës nga Drejtoria e Investimeve Kapitale që i kanë përpunuar specifikat, kanë vendosur të shkojnë me këto materiale, por kjo nuk do të thotë që vitin tjetër nuk e bëjmë një ndryshim nëse e shohim që një material tjetër është më i mirë dhe më i përshtatshëm.

Mbledhja përfundoj në orën 15:20.

Procesmbajtësi:
Arton Brahim

Faqe 6 nga 6

Faqe 7 nga 6

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë Telefon:
+ 381(0)38/230-900
<http://www.pristina-komuna.org>

Pjesëmarrja në diskutime publik lidhur me Planifikimin e buxhetit të vitit 2023,

më 09.08.2022.

Emri dhe Mbiemri	Gjinia M/F	E-mail	Nënshkrimi
1 Gjentezije Gashi			
2 Albonë Dësha			
3 LUMNIFE ÇITAKU Indrie Gendeg			
4 RIFADITE SOR			
5 MIRAZIN VITINGA			
6 Suprena Shala			
7 Betim Syllimiri			
8 FATUJE SHODRUA			
9 Besart Ismajli			
10 Islami Nitaj			
11 Mazir Todor			
12 BETIJE KORQA			
13 Kresida Rofaj			
14 NAIN BYTYRI			
15 MURZAN KRASHI			
16 FATHIR DERVIDAS			
17			

18	Shyqpe Kyryu
19	Enmal Dsmqni
20	PASHIT BASHI
21	GERRA SUEGUA
22	Arben Kelmendi
23	Besant Krasniq
24	Gerim Mehmeti
25	Violeta Solaku
26	Dearente Allira
27	TRIEBA KASUMI BERSHYA
28	Fatmirë Rizni-KRAMD
29	SUPRIJE ZHITITJA
30	Hemzetulla Begim
31	Daut Selimi
32	Nali Dulaku
33	Haki Dili
34	Behar Mulesi
35	Amim Gashi
36	Skender HAJMI
37	Myllazim Nafari
38	Isak Xhemajti
39	Karimë Osmani

40

Bealije Pizera

41

Jeta Diela Bajani

